

KËRKESË PËR SHPREHJE TË INTERESIT

Kosovë

**Fuqizimi i Kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit në auditimin e Prokurimit Publik
Projekti Nr. P160382**

Granti Nr.:TF0A3821

Titulli i Detyrës: Shqyrtimi dhe analizimi i kornizës së prokurimit publik dhe ngritja e kapaciteteve në auditimin e projekteve të financuara nga donatorët

Nr. Referencës. XK-NAO-94905-CS-INDV

Historiku

Banka Botërore është duke e financuar një program për të promovuar përmirësimin e proceseve të prokurimit në Kosovë që kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve më efikase dhe efektive tek qytetarët. Përmirësimi i kontrolleve të aplikuara në proceset e prokurimit do të ngritë zhvillimin në shkallë më të gjerë të Menaxhimit të Financave Publike, të cilat do të përmirësohen edhe me tej nga një qasje më e avancuar e Zyrës Kombëtare të Auditimit në auditimin e projekteve të financuara nga donatorët me fokus në fushën e prokurimit.

Granti do të kontribuojë në fuqizimin e kapaciteteve të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës për auditimet e rregullsisë në projekte të ndryshme të financuara nga donatorë ndërkombëtarë sikurse Banka Botërore, Komisioni Evropian, dhe SIDA, etj. Me fokus në fushën e prokurimit dhe në sistemin e disbursimeve të mjeteve financiare, duke e avancuar në këtë mënyrë procesin e prokurimit publik përmes shtimit të vlerës nga vlerësimet dhe rekomandimet e dhëna.

Fushëveprimi

Puna e ndërmarrë do të fokusohet në detyrat ne vijim:

A). Të kryejë një studim të strukturës së prokurimit publik dhe ndikimit relativ në planifikimin e auditimeve të prokurimit. Ky aktivitet do të referohet detyrave në vijim:

- Rishikimit të rezultateve të vlerësimit të PEFA-së të kryer në nivel kombëtar dhe lokal në Kosovë gjatë viteve të shkuara, për të kuptuar ndikimin e statusit të MFP në auditimin e prokurimit;

- Rishikimit të përgjithshëm të pozicionimit të prokurimit në Kosovë në nivel vendi, përfshirë akterët kyç dhe zhvillimet në Prokurimin Publik, dhe deri në çfarë mase kjo nxit një strategji të rishikuar (të bazuar në rrezik dhe të fokusuar në ndikim) dhe që mbështet një aktivitet më të fokusuar të auditimit në prokurim, me një vlerësim më të mirë të rrezikut mbi atë se ku qëndrojnë çështjet kyçe të auditimit.

B). Do të kryhet monitorimi i tre (3) auditimeve që do të ndërmerren në procesin e prokurimit tek Projektet e Donatorëve për të ekzaminuar aktivitetet e prokurimit pasi të jenë kryer ato nga Huamarrësi/Pranuesi. Këshilltari pritet të marrë pjesë dhe të bëjë mentorimin e ekipeve të auditimit përgjatë të gjitha fazave gjatë një detyre të caktuar auditimi: Konsideratat fillestare, planifikimin dhe dizajnimin, përgatitjen dhe mbledhjen e dëshmive të auditimit, vlerësimin e dëshmive dhe përpilimin e konkluzioneve, raportimin, e me theks të veçantë në pikat ne vijim:

- Të udhëheq ekipet e auditimit në zhvillimin e planit të auditimit duke marrë parasysh bazat ligjore mbi prokurimin, kriteret e auditimit dhe strategjinë, materialitetin, vlerësimin e rrezikut, etj.:

- Zhvillimin e programeve efektive të auditimit, dhe mentorimin e ekipeve të auditimit gjatë kryerjes së auditimit, mbledhjen dhe vlerësimin e dëshmive, dhe përpilimin e konkluzioneve;

- Të ndihmojë gjatë shkrimit të raportit të auditimit, identifikimin dhe arsyetimin e të gjeturave të auditimit, dhe rrezikun që shoqëron prokurimin, dhe zhvillimin e rekomandimeve praktike dhe të fuqishme.

C). Të ofrojë trajnime mbi rregulloren e prokurimit të donatorëve, duke shqyrtuar një numër donatorësh, përfshirë KE-në dhe Bankën Botërore. Do të zhvillohet një program fillestar për auditorët e ZKA-së në lidhje me auditimin e pajtueshmërisë në prokurim, bazuar në rezultatet e aktivitetit A dhe B, duke marrë parasysh shkathtësitë ekzistuese në ZKA.

D). Do të marrë pjesë në një punëtori dhe në aktivitetet tjera (që do të caktohen më vonë) bazuar në arritjet e planifikuara dhe ato finale të detyrës së caktuar.

Kualifikimet

Kompetencat:

- PEFA- duhet të ketë njohuri të lartë të Reformave në Menaxhimin e Financave Publike, të një strukture të vlerësimit dhe të raportimit mbi përparësitë dhe dobësitë e menaxhimit të financave publike.
- Parimet e prokurimit – të ketë njohuri të thellë të parimeve të prokurimit publik, rregulloreve , sistemeve, dhe të qasjeve në prokurimin ndërkombëtar, me aftësi të dëshmuar, me qëllim që të ofrojë në mënyrë të pavarur analiza të hulumtuara mirë të çështjeve dhe problemeve komplekse të prokurimit;
- Rregulloret Regjionale të Prokurimit – të jetë i aftë për ofrimin e këshillave pragmatike dhe të kualifikuara në aplikimin e rregulloreve dhe procedurave të prokurimit, të lidhura me dizajnim dhe implementim;
- Menaxhim Operativ të Projektit – demonstroi njohuri të thella dhe kupton mekanizmat & metodologjitë e menaxhimit të projektit, dhe të proceseve që ndërlidhen me përgatitjen & implementimin e projektit, menaxhimin e resurseve, dhe komunikimin me palët e interesit;
- Orientim ndaj Klientit – Mban marrëdhënie me klientë në rast të ballafaqimit me kërkesa kundërthënëse;
- Dëshira për Rezultate – identifikon burimet e nevojshme për të arritur rezultate duke përfshirë palët e shumta të interesit, dhe gjen zgjidhje kundrejt pengesave që ndikojnë në rezultatet kyçe;
- Puna në ekip (Bashkëpunimi) dhe Përfshirja – demonstroi aftësi udhëheqëse duke siguruar që ekipi të qëndrojë i fokusuar dhe i organizuar, dhe në mënyrë aktive kërkon dhe merr në konsideratë idetë dhe qasjet e ndryshme.
- Njohuritë, të mësuarit dhe Komunikimi – Udhëheq në ndarjen e praktikave më të mira, trendëve, njohuritë dhe mësimet e marra nëpër njësi, me klientët dhe partneret, duke i artikuluar idetë me gojë dhe me shkrim, në mënyrë bindëse, tek audiencat e niveleve të ndryshme; dhe
- Gjykim Biznesi dhe Vendim - Marrje Analitike – mbledh informata, vlerëson rrezikun, merr parasysh ndikimin dhe artikulon përfitimin nga vendimet për palët e brendshme dhe të jashtme të interesit në kuptim afatgjatë.

Kriteret e përzgjedhjes:

- Shkollim Universitar në degën e Drejtësisë, Ekonomisë apo Administrimit Publik (preferohet shkollimi master);
- Së paku gjashtë vite përvojë pune në fushën e prokurimit në sektorin publik, dhe së paku 3 vite përvojë në veprimtaritë e prokurimit të projekteve të financuara nga donatorët:

- Njohuri të mira të rregulloreve dhe procedurave të prokurimit të institucioneve financiare multilaterale (p.sh preferohet Banka Botërore), dhe të agjencive të zhvillimit të bashkëpunimit; si dhe njohuri të mirë të aspekteve institucionale, teknike dhe komerciale të prokurimit;
- Auditor i Certifikuar nga autoritetet/shoqatat kompetente, e dëshirueshme;
- Së paku një detyrë të ngjashme të kryer me sukses në ndonjë nga Institucionet Shtetërore të Auditimit apo në Institucionet e Sektorit Publik (të vërtetuar me dëshmi formale, p.sh. me letër referencë);
- Të jetë anëtar i një institucioni përkatës p.sh. Instituti i certifikuar për Prokurim dhe Furnizim, e dëshirueshme; dhe
- Përvojë në trajnim, mentorim dhe ngritje të kapaciteteve në projekte të financuara nga donatorë në ndonjë organizatë, e dëshirueshme.

Kohëzgjatja

Pritet që kohëzgjatja e detyrës të jetë rreth 40 ditë, me bazë-lokacion në Prishtinë, dhe të përfundojë deri me 31/09/2019.

Personat e kualifikuar dhe me përvojë do të përzgjidhen në bazë të dispozitave të Rregulloreve të prokurimit të Bankës Botërore për Financimin të Projekteve të Investimit(FPI) për Huamarrës, Korrik 2016, të bazuar në metodat e përzgjedhjes për Këshilltarë Individual(KI),(Përzgjedhje për Konkurrim të Hapur për Këshilltarë Individual).

Këshilltarët e interesuar vendor duhet të ofrojnë informata që dëshmojnë se ata kanë kualifikimet e nevojshme dhe përvojën përkatëse për të kryer Shërbimet në fjalë.

Informatat tjera mund të merren në adresën e poshtëshënuar gjatë orëve të punës: nga ora 08:00 deri më 16:00.

Të interesuarit duhet të dorëzojnë në formë të shkruar kërkesën për shprehje të interesit në adresën e poshtëshënuar (personalisht apo përmes postës elektronike) nga data 18 Mars 2019. Deri me datën 01.04.2019

Zyra Kombëtare e Auditimit,

Attn: Jehona Krasniqi

Rr. Ahmet Krasniqi, 210

10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

E-mail: jehona.krasniqi@oagks.org